

FATMIRA MUSAJ

**MASA PËR REFORMIMIN E SISTEMIT TË TAKSAVE
DHE TATIMEVE NË VITET E REPUBLIKËS SHQIPTARE
(1925-1928)**

Vijon

Burimi kryesor i të ardhurave në buxhetin e shtetit, ishin tatimet e taksat. Sistemi tatimor, i trashëguar nga sundimi osman me ndonjë ndryshim të parëndësishëm, vazhdoi të vepronte edhe pas krijimit të shtetit të pavarur shqiptar. Veç kësaj, mbledhja dhe administrimi i të ardhurave prej taksave dhe tatimeve, ishte një veprimtari e paorganizuar mirë dhe problematike. Një sërë faktorësh kishin ndikimin e tyre negativ në funksionimin e sistemit tatimor në Shqipëri. Situata e brendshme dhe e jashtme e Shqipërisë në vitet 1912-1920, bëri që qeveritë e kësaj periudhe, të angazhoheshin më tepër me ruajtjen e pavarësisë e integritetit territorial të shtetit se sa me funksionimin e tij të brendshëm. Gjithashtu, mungesa e stabilitetit politik deri në vitin 1925, mundësia dhe aftësia realizuese e kufizuar e administratës shtetërore, mentaliteti dhe metodat e vjetruara në mbledhjen e të ardhurave, veprimet abuzive të autoriteteve të pushtetit dhe nëpunësve të administratës, bënë që potenciali i pasurisë kombëtare të shfrytëzohej pak për fuqizimin e buxhetit të shtetit.

Në fillim të vitit 1925, qeveria shqiptare, në kushtet kur arka e shtetit ishte pothuajse e boshatisur, krahas përpjekjeve për të siguruar mjetet financiare aq të domosdoshme nga një hua e jashtme, e përqendroi vëmendjen tek faktori i brendshëm. Hapi i parë për të vënë në veprim mundësitë dhe burimet financiare të shoqërisë shqiptare, ishte evidentimi dhe mbledhja e tatimeve të prapambetura të viteve 1912-1924. Në fillim të vitit 1925, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) urdhëronte prefektët në të gjithë vendin që brenda një kohe të shkurtër, pa marrë parasysh asnjë ankim apo kundërshtim, t'i jepnin fund mbledhjes së tatimeve të prapambetura. “Shteti, theksonte MPB, mbahet me të holla,

prandaj detyra kryesore e zotnisë tuaj, është të mbledhunit e këtyre”.¹ Kështu, zyrat e financave në prefektura e nënprefektura, të mbështetura dhe nga forcat e xhandarmërisë, në vitet 1925-1928, arritën të grumbullonin rreth 7 milion fr.ar nga detyrimet e prapambetura. Shuma e mbledhur përbënte një përqindje të vogël krahasuar me atë që duhej të mbledhej në ato vite.² Ky rezultat jo i kënaqshëm ishte pasojë e pamundësisë ekonomike të fshatarësisë për shlyerjen e tatimeve të prapambetura si dhe mentalitetit të trashëguar nga sundimi osman, për t’iu shmangur detyrimeve ndaj shtetit. Masat e rrepta që mori qeveria për mbledhjen e tyre, hasën në kundërshtime nga popullata, sidomos në zonat e malësisë së veriut si në Pukë, Malësi e Madhe, Dibër, Tropojë etj.³ Droja se pakënaqësia mund të shndërrohej në lëvizje kundër regjimit e të shtrihej dhe në zona të tjera të vendit, në fund të vitit 1925, e shtyu Kryesinë e Republikës, të mendonte për faljen e një pjese të të prapambeturave në disa zona të veriut. Por ky propozim u kundërshtua nga MPB me arsyetimin se mund t’i hapej rrugë kundërshtimit nga popullsia të mbledhjes së taksave në të gjithë vendin.⁴ Grumbullimi i tatimeve të prapambetura mbeti një burim i kufizuar të ardhurash për buxhetin e shtetit. Prandaj, qeveria e përqendroi vëmendjen në grumbullimin e taksave e tatimeve të viteve 1924-1925 e në vazhdim.

Mbështetur në dokumentacionin arkivor dhe studimet e deritanishme për sistemin tatimor në Shqipëri, po ndalemi shkurtimisht në problematikën që kishte sistemi tatimor në ato vite dhe nevojën për reformimin e tij. Aktorët pjesëmarrës në realizimin e atij sistemi shprehnin interesa të ndryshme. Shteti synonte të grumbullonte të ardhura në arkën e tij, pa të cilat nuk mund të kryente asnjë funksion. Për këtë qëllim, qeveria hartoi politika tatimore, për realizimin e të cilave propozoi ligje e nxori një sërë aktesh nënligjore. Nëpunësit e administratës financiare dhe autoritetet e pushtetit qendror e sidomos ai

¹ Arkivi Qendror Shtetëror i Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 178, viti (më tej: V.) 1925, dosja (më tej: D.) VI-212, fl. 37. Qarkore e MPB, drejtuar prefekturave e nënprefekturave, shkurt 1925; Beqir Meta, *Politika tatimore e shtetit shqiptar 1925-1939*, Tiranë: Shkenca, 1999, f. 23.

² B. Meta, *Politika tatimore.....*, f. 26.

³ AQSH, F. 152, V. 1926, D. 11, fl. 1. Telegram i komandantit të zonës së veriut Fiqiri Dine drejtuar MPB, Tiranë, më 22 janar 1926. Të dhëna për rezistencën e popullsisë së këtyre zonave jepen edhe në faqet 34, 36, 43 të kësaj dosje, si dhe në: *po aty*, F. 346, V. 1925, D. 141, fl. 66.

⁴ *Po aty*.

lokal, nga njëra anë vepronin për zbatimin e ligjeve të sistemit tatimor dhe nga ana tjetër, synonin të nxirrnin përfitime personale me metoda abuzive e korruptive gjatë ushtrimit të detyrës. Pronarët, duke shfrytëzuar pushtetin e tyre ekonomik, ndikonin tek nëpunësit e administratës për t'iu shmangur shlyerjes së detyrimeve tatimore të përcaktuara me ligjet në fuqi. Në këtë mënyrë ata rritnin pasurinë e tyre dhe dëmtonin arkën e shtetit. Një grup jo i vogël tagrambledhësish dhe sidomos dhjetarët, duke përfituar nga mungesa e dokumentacionit të saktë për pronat, në bashkëpunim dhe me autoritetet vendore, vepronin në mënyrë abuzive e korruptive. Ata synonin që, nga njëra anë të grumbullonin sa më shumë të ardhura nga fshatarët qoftë dhe në mënyrë të jashtëligjshme dhe nga ana tjetër, të dorëzonin sa më pak në arkën e shtetit. Ky grup nxirrte fitime të majme në kurriz të fshatarëve. Kjo e fundit dhe pronarët e vegjël mbi të cilët rëndonte pesha më e madhe e sistemit tatimor, në forma e mjete të ndryshme, kundërshtonin likuidimin e tatimeve dhe taksave. Mundësitë e tyre ekonomike për t'u përballur me shlyerjen e tatimeve të shumta ishin tepër të kufizuara. Kështu sistemi tatimor në vitet e Republikës ruante tiparet themelore të një sistemi të prapambetur të një shteti jo të zhvilluar.⁵

Megjithë masat e marra në këto vite për përmirësimin e sistemit tatimor, efektiviteti i tyre mbeti shumë i kufizuar.

Sistemi tatimor përbëhej nga tatimet e drejtpërdrejta dhe ato të tërthorta. Të ardhurat në buxhetin e shtetit nga tatimet e drejtpërdrejta siguroheshin nga dhjeta, xhelepi, vergjia, tatimi mbi fitimet, tatimi mbi të ardhurat, tatimi mbi pyjet, private dhe guroret.⁶ Peshën më të madhe në të ardhurat prej tatimeve direkte e zinte e dhjeta. Ajo përbënte pothuajse gjysmën e tyre dhe afërsisht 14% të totalit të të ardhurave shtetërore në ato vite.⁷ E dhjeta ishte një taksë përpjesëtimore që i merrej fshatarit për të gjitha prodhimet bujqësore si drithëra, duhan, ullinj, rrush etj., në masën e 1/10 së prodhimit.⁸ Por, çka rëndonte më shumë gjendjen e fshatarësisë dhe dëmtonte arkën e shtetit, ishte sistemi i sipërmarrjes në mbledhjen e saj dhe të taksave të tjera të drejtpërdrejta. Sistemi i sipërmarrjes së të dhjetës konsistonte, në të drejtën që fitonte një grup i

⁵ B. Meta, *Politika tatimore e shtetit ...*, f. 19.

⁶ *Po aty*, f. 27.

⁷ *Po aty*.

⁸ Aleko Haxhi, "Politika financiare antipopullore e regjimit zogist", në *Studime historike*, nr. 1, Tiranë: 1966, f. 78-79.

caktuar njerëzish, për të mbledhur taksat kundrejt një pagese të caktuar ose të një garancie pasurore të barabartë ose të përafërt me shumën që detyrohej të derdhte në arkën e shtetit nga taksat. Sipërmarrësit binin në ujdë midis tyre dhe në bashkëpunim me nëpunësit që organizonin konkurrimin, përpiqeshin që nga të ardhurat, të mbanin sa më shumë për vete e të ofronin sa më pak për arkën e shtetit. Gjithashtu, kishte mjaft raste kur, sipërmarrësit që blenin të dhjetat, në mungesë të dokumenteve, regjistrimeve kadastrorë e pasurore etj., paraqitnin para komisionit dëshmi të vërtetuara nga pleqësitë për zotërim pasurie disa herë më të madhe nga sa ata zotëronin. Ata, pasi paguanin një ose dy këste, largonin pasurinë nga shtëpitë e tyre dhe nuk i paguanin këstet e tjera.⁹ Në këtë mënyrë edhe në rast se u konfiskohej pasuria për mosderdhjen e detyrimit sipas kontratës, dilnin të fituar pasi shuma që kishin mbledhur nga e dhjeta ishte shumë më e madhe nga ajo çka mund t'u konfiskohej. Veprime të tilla abuzive e korruptive dëmtonin rëndë arkën e shtetit dhe shkaktonin konflikte midis fshatarëve dhe sipërmarrësve të së dhjetës.

Për të shmangur efektet negative të sistemit tatimor dhe për të përmirësuar gjendjen financiare të vendit, Zogu i kërkoi ministrit të Financave, S. Starovës që të ngrinte një komision dhe të përgatiteshin ligje të reja moderne mbi të gjitha taksat shtetërore.¹⁰ Kështu, në vitin 1926 qeveria shpalli se do të hiqte taksën e së dhjetës e ta zëvendësonte me tatimin mbi tokën.¹¹

Për të bërë të mundur përcaktimin dhe vjeljen e tatimit mbi tokën, ishte i nevojshëm regjistrimi kadastror i tokës, i cili në Shqipëri mungonte. Prandaj KM, vendosi të kryhej rilevimi topografik kadastror i Shqipërisë, i cili do të realizohej nga Instituti Gjeotopografik i Firences. Në tetor 1926, me këtë institut u nënshkrua një kontratë pune.¹² Pas dorëzimit të 70-80 planeve kadastrorë të Tiranës e disa viseve të tjera, punonjësit e këtij instituti u tërhoqën pa e përfunduar punën. Kjo erdhi ndoshta edhe për neglizhim të qeverisë shqiptare, për ngritjen pranë këtij misioni të një zyre me specialistë shqiptarë, të cilët kishin për detyrë të plotësonin parcelat e hartuara nga specialistët italianë, të emërtonin

⁹ *Po aty*, f. 28.

¹⁰ *AQSH*, F. 178, V. 1925, D. III-93, fl. 1. Letër e Kryesisë së Republikës drejtuar S. Starovës, Tiranë, më 28 shtator 1925.

¹¹ B. Meta, *Politika tatimore e shtetit ...*, f. 27.

¹² Haxhi Shkoza, *Financat e Shqipërisë (1839-1934)*, Tiranë: Shtypshkronja Nikaj, 1935, f. 170; shih *Fletorja Zyrtare*, nr. 219, Tiranë: 1926.

pronarët përkatës, të shënonin kufijtë e tyre dhe të klasifikonin tokat. Kjo punë e përbashkët do të bënte të mundur plotësimin e kushteve të aplikimit të tatimit mbi tokën. Duket se kjo ndërmarrje u pengua edhe nga elementë brenda qeverisë, të cilët ishin të interesuar të mbanin në veprim sistemin e të dhjetës. Kështu, për arsye “kursimi” u suprimua dhe vendi i të vetmit nëpunës që punonte pranë italianëve.¹³

Megjithatë, parlamenti miratoi ligjin mbi tatimin e tokës, i cili u dekretua në janar 1928.¹⁴ Sipas këtij ligji, masa e tatimit mbi tokën do të caktohej për çdo fshat në bazë të çmimit mesatar të shitjes së të dhjetave gjatë viteve 1921-1926.¹⁵ Ashtu si dhe e dhjeta, tatimi mbi tokën ishte tatim proporcional dhe tarifa më e lartë vendosej mbi tokat e bukës që zinin sipërfaqen më të madhe të tokave të punuara në vend, duke përfshirë edhe tokat e lëna ugar apo djerr (të pa mbjella). Kjo rrëronte së tepërmi ekonominë e fshatarit, i cili pavarësisht nga prodhimi, duhej të shlyente vlerën e caktuar të detyrimit. Prandaj ligji u ankimua nga fshatarët. Kështu, rreth 30 fshatra të zonës së Bilishtit, në ankesën drejtuar Senatit shkruanin: “Po të merret për bazë caktimi i tatimit simbas asajë dispozite, ne bujqit kemi për t’u detyruar me një pagesë të madhe, të cilës nuk mund t’i bëhet ballë me vlerën e pakët që ka bereqeti e me shpenzimet e mëdha që kemi për të bamun për të marrë prodhimet e pronjave tona. Është e vërtetë se sistemi i së dhjetës duhet zhdukur me çfardo mënyrë, porse zhdukja e tij, duhet të ketë kurdoherë për qëllim lehtësimin e bujqut të mjeruem, e nuk duhet të ketë asnjë qëllim që ta rëndojë bujqun më shumë se tash, kurse ka qenë sistemi i së dhjetës.”¹⁶

Megjithë vërejtjet dhe kundërshtimet që iu bënë ligjit nga fshatarët, gjatë viteve 1926-1927 dhe diskutimeve pro e kundër në administratën e financave, parlamenti autorizoi qeverinë të aplikonte zbatimin e ligjit vetëm në nënprefekturën e Lezhës.¹⁷ Nga popullata e kësaj zone, heqja e të dhjetës u prit me gëzim por u bënë propozime për korrigjimin e nenit 26 e 36 të ligjit ku përcaktohej mënyra e mbledhjes së tatimit mbi tokën. Funksonari i financave që ishte dërguar në Lezhë për të ndjekur zbatimin

¹³ *Po aty*.

¹⁴ *Fletorja Zyrtare*, nr. 11, Tiranë: 24 janar 1928.

¹⁵ *Fletorja Zyrtare*, nr. 64, Tiranë: 1928, art. 2 i dekretligjit mbi tatimin e tokës, 8 prill 1928.

¹⁶ B. Meta, *Politika tatimore e shtetit*, f. 30.

¹⁷ *Fletorja Zyrtare*, nr. 64, Tiranë: 1928. Dekretligjë 8 prill 1928.

e tatimit mbi tokën, i mbështeti propozimet dhe ia sugjeroi qeverisë.¹⁸ Megjithë “përpyekjet” e qeverisë për zbatimin e ligjit të tatimit mbi tokën ai nuk arriti të aplikojë. Për këtë qeveria u detyrua ta shfuqizonte e të kthente përsëri tatimin e të dhjetës. Argumenti me të cilin qeveria arsyetoi veprimin e saj, ishte mungesa e mjeteve financiare për të ngritur një aparat administrativ, i cili do të garantonte zbatimin e tatimit mbi tokën. Ky justifikim nuk ishte shumë bindës sepse shpenzimet për mbajtjen e një aparati të tillë do të ishin më të pakta se sa ato që harxhoheshin për të mbajtur e financuar një masë të madhe kontrollorësh e informatorësh që vepronin për të nxjerrë tatimet e taksat e shtetit. Por, qeveria dhe në tërësi sistemi ekonomik i Shqipërisë i këtyre viteve nuk ishin ende të përgatitur për të bërë ndryshime radikale në sistemin e të dhjetës.¹⁹ Sipas studiuesit H. Shkoza, tatimi i së dhjetës ishte aplikuar në të gjitha vendet e qytetëruara, por zëvendësimi i saj me tatimin mbi tokën, kishte kaluar të gjitha evolucionet deri sa kishte marrë formën e tatimit mbi të ardhurat neto.²⁰

Një tatim me vlerë jo të vogël në të ardhurat e buxhetit të shtetit, ishte taksa e xhelepit (tatim mbi bagëtinë) që përbëhej nga një vlerë e caktuar për çdo bagëti të imët. Zogu, në kuadrin e përpjekjeve për të reformuar sistemin tatimor dhe në të njëjtën kohë, për të ulur pakënaqësinë e fshatarësisë ndaj politikës tatimore të ndërmarre nga qeveria, dekretoi ligjin sipas të cilit përjashtoheshin nga xhelepi pronarët me më pak se 100 kokë bagëti të imta.²¹ Disa muaj më vonë qeveria u detyrua ta shfuqizonte dekretligjin, sepse zbatimi në praktikë i tij do të çonte në eliminimin e këtij tatimi, pasi shumica e fshatarëve nuk e kishin atë sasi bagëtie dhe pjesa tjetër për t’iu shmangur tatimit, do të përdorte mënyra të ndryshme për të fshehur numrin real të bagëtive. Kështu, në qershor 1926 parlamenti shfuqizoi dekretligjin dhe vendosi tarifën e xhelepit duke e shtrirë atë mbi të gjithë llojet e blegtorisë.²² Edhe tatimi mbi ndërtesat ose vergjia nuk ndryshoi. Në tatimet e drejtpërdrejta ishin,

¹⁸ H. Shkoza, *Financat e Shqipërisë...*, f. 180.

¹⁹ B. Meta, *Politika tatimore në Shqipëri...*, f. 57.

²⁰ H. Shkoza, *Financat e Shqipërisë...*, f. 213.

²¹ *AQSH*, F. 152, V. 1926, D. 499, fl. 21; shih B. Meta, *Politika tatimore në Shqipëri ...*, f. 32.

²² *Ligje, dekretligje, rregullore të vjetit 1927*, vëll. 4, Tiranë: Këshilli i Shtetit, 1939, f. 185. Dekretligjë mbi taksën e xhelepit.

tatimi mbi të ardhurat, mbi trashëgiminë, tatimi mbi fitimin me të cilin tatoheshin shtresat e pasura.²³

Një taksë tjetër që rëndoi gjendjen e fshatarësisë, veçanërisht atë të bujqve që ishin vendosur në çifligjet e shtetit, ishte *tatimi i topjakut* që merrej për bagëtitë. Kjo taksë, e cila paguhej për herë të parë në vend, u kundërshtua nga fshatarët pasi e kishin të pamundur shlyerjen e saj me tarifa të larta e përmasa të mëdha.²⁴

Përpjekjet e qeverisë për reformimin e sistemit të taksave të drejtpërdrejta veçanërisht për zëvendësimin e tatimit të së dhjetës, lehtësimin e xhelepit etj., nuk rezultuan të suksesshme si në shtimin e të ardhurave në buxhetin e shtetit ashtu edhe për përmirësimin e gjendjes së fshatarësisë. Anulimi i kësaj nisme si dhe vendosja e tarifave të reja mbi to, kushtëzohej nga nevoja e madhe e shtetit për të ardhura financiare, ekzistenca e mbeturinave feudale në ekonominë bujqësore e blegtorale, dhe e mentalitetit të trashëguar nga e kaluara për t'iu shmangur pagimit të taksave e tatimeve në përgjithësi. Veçanërisht dhjetarët ishin kundërshtarë të çdo reforme në sistemin e tatim taksave. që prekte interesat dhe burimet pasurore të tyre. Vështirësitë ekonomike të popullsisë dhe rritja e qëndrësës kundër politikës tatimore të shtetit, bënë që shuma të rëndësishme të tatimeve të drejtpërdrejta, të mos arkëtoheshin në buxhetin e shtetit.

Parë në tërësinë e tyre, tatimet e drejtpërdrejta bënë që regjimi të mos ndihej mirë, jo vetëm se nuk siguroheshin të ardhurat e mjaftueshme në arkën e shtetit, por edhe për faktin e rritjes së pakënaqësisë në popull. Në këto kushte qeveria e pa të nevojshme ndërhyrjen në sistemin e tatim-taksave.

Mbështetur në përvojën e vendeve të përparuara evropiane, për herë të parë ajo ndërhyri në reformimin e tatimeve të tërthorta. Ndërhyrja e shtetit konsistoi në shtimin e llojeve të këtyre tatimeve dhe në rritjen e atyre ekzistuese, të cilët ndikuan në rritjen e peshës specifike të të ardhurave në buxhetin e shtetit.²⁵ Kështu, nga 10, 3 milion fr.ar në vitin 1925-1926, të ardhurat prej tyre arritën në 15 milion fr. ar në vitin 1928-1929, duke zënë 54, 3% të totalit të të ardhurave buxhetore.²⁶ Tatimet e

²³ *Fletorja Zyrtare*, nr. 67, Tiranë: 1928. Dekretligj mbi tatimin mbi fitimin.

²⁴ B. Meta, *Politika tatimore në Shqipëri...*, f. 35.

²⁵ H. Shkoza, *Financat e Shqipërisë...*, f. 424; B. Meta, *Politika tatimore në Shqipëri ...*, f. 36.

²⁶ *Buxheti konsumtiv i ushtrimit financiar 1928-1929*, Tiranë: 1931.

tërthorta përbëheshin nga tatimet doganore dhe tatimet e konsumit. Forcimi i tatimeve doganore dhe i atyre të konsumit dëshmonte se ekonomia shqiptare tashmë kishte hyrë në ekonominë e tregut. Në vitin 1925 shteti vendosi sistemin e ri të tarifave doganore.²⁷ Në këtë periudhë taksa doganore mori rëndësi të veçantë sepse po zgjerohej eksport-importi i mallrave të konsumit të gjerë, i lëndëve të para, i materialeve të ndërtimit dhe i mjeteve të punës dhe atyre industriale. Në vitet 1925-1928 qeveritë shqiptare lidhën marrëveshje e traktate tregtare me një sërë shtetesh. Shqipëria zhvillonte eksport-import jo vetëm me të gjitha vendet e Europës, por dhe me SHBA, Japoninë, Egjiptin, Turqinë etj. Vlera e mallrave që eksportonte Shqipëria në vitin 1925, kapte shifrën 17.122.751 fr. ar, në vitin 1926, 11. 903.982, fr. ar, në vitin 1927, 11. 106. 9011 fr. ar, në vitin 1928, 14. 694.203 fr. ar, ndërsa vlera e mallrave të importuar arriti në vitin 1925, 21.800411 fr. ar, në vitin 1926, 14.804.741 fr. ar, në vitin 1927, 24.081.884 fr. ar, në vitin 1928, 32.311.583 fr. ar.²⁸ Disa shteteve iu dha statusi i kombit më të favorizuar, në mënyrë të veçantë Italisë, me të cilën realizohej volumi më i madh i eksport-importit (61% e eksportit dhe 58% e importit).²⁹ Ndonëse dhënia e statusit të kombit më të favorizuar pati ndikim pozitiv në zhvillimin e tregtisë dhe tërheqjen e kapitalit të huaj, ajo pengoi shtetin shqiptar që megjithëse gëzonte të njëjtën pozitë me ta, të ndiqte një politikë proteksioniste dhe të shtonte të ardhurat fiskale nëpërmjet doganave.³⁰ Megjithëse në kushtet e një bujqësie ekstensive dhe të një industrie të prapambetur, prodhimi vendas e kishte të domosdoshme mbrojtjen e shtetit. Prandaj qeveria mori disa masa në interes të prodhimit. Kështu, ligji mbi tarifën e reja doganore, i miratuar në qershor 1926,³¹ rriti tarifën doganore për disa produkte natyrore dhe ato të industrisë të sapunit, lëkurëve, prodhimeve me punë dore, fshesave, si dhe për disa artikuj gjysëm të manifakturuar që deri në atë kohë ishin të barabarta me ato të manifakturuara. Për të inkurajuar zhvillimin e zejtarisë dhe industrisë, ligji përjashtonte nga tagra veglat e punës që sillnin zejtarët dhe mekanikët për të ushtruar aktivitetin e tyre. Nga taksa doganore u

²⁷ B. Meta, *Politika tatimore në Shqipëri ...*, f. 38.

²⁸ H. Shkoza, *Financat e Shqipërisë...*, f. 498-499.

²⁹ *Po aty*, f. 418.

³⁰ B. Meta, *Politika tatimore në Shqipëri ...*, f. 37.

³¹ *Fletorja Zyrtare*, nr. 100, 104, Tiranë: 1926. Ligji mbi tarifën doganore, qershor 1926.

përfashtuan materialet që vinin për familjen e Zogut.³² Ky ligj veproi edhe në vitet e monarkisë por me ndryshime e përmirësime të herëpashershme që i u bënë në përputhje me kërkesat e kohës.

Qeveria gjatë viteve 1925-1928, në përpjekjet e saj për të nxjerrë nga veprimtaria e doganave sa më tepër të ardhura për buxhetin e shtetit, u ndesh me probleme e vështirësi të ndryshme. Sipas marrëveshjes me “Shoqërinë për Zhvillimin Ekonomik të Shqipërisë” (Società per lo Sviluppo Economico dell Albania - SVEA) për shlyerjen e huasë nga të ardhurat e doganave të shtetit shqiptar, u krijua mundësia që këto të fundit të viheshin nën kontrollin e Italisë. Sipas kësaj marrëveshjeje, qeveria shqiptare nuk kishte të drejtë të bënte asnjë ndërhyrje në sistemin tatimor të doganave pa pëlqimin e SVEA-s. Mbështetur në këtë marrëveshje, Roma i imponoi shtetit shqiptar heqjen e të gjitha tagrave doganore për materialet që do të importoheshin nga Italia për ndërtimin e objekteve me kredinë e asaj shoqërie.³³ Po kështu, marrëveshjet u jepnin të drejtën shoqërive koncesionare të huaja, për të mos iu nënshtruar taksave doganore për mallrat që ato eksportonin nga Shqipëria për në shtetet e tjera.

Qeveria shqiptare, për të siguruar sa më shumë të ardhura, vendosi taksa doganore të larta edhe për mallrat e konsumit të përditshëm. Këto taksa, ndonëse rritën të ardhurat në arkën e shtetit dhe u konsideruan si masë mbrojtëse për prodhimin vendas, kushtëzuan çmimin e lartë të mallrave jetikë për shtetasit, ulën fuqinë blerëse duke ndikuar në përkeqësimin e gjendjes së tyre ekonomike. Tarifatat e larta doganore ndikuan negativisht në zhvillimin e tregtisë dhe në ekonominë e vendit.³⁴

Reforma në sistemin doganor

Zbatimi i ligjit të ri për tarifatat doganore dhe përmirësimi i vazhdueshëm i tij, kërkonte marrjen e masave për reformimin e sistemit doganor si në strukturë dhe në funksionimin e tij. Rrjeti i doganave si në kufirin tokësor ashtu dhe në atë ujor, ishte tepër i gjerë dhe shtrihej në: Shëngjin, Shkodër, Patok, Durrës, Seman, Vlorë, Spile (Himarë), Sarandë, Dhivër, Konispol, Kakavijë, Ura Berat, Kapshticë, Goricë,

³² *Po aty*; AMPJ, V. 1926, D. 166, fl. 47. Ligjë për përjashtimin nga tarifa doganore të materialeve të importuara për ndërtimin e vilës së A. Zogut, qershor 1926.

³³ B. Meta, *Politika tatimore në Shqipëri ...*, f. 38.

³⁴ *Po aty*.

Pogradec, Qafë-Thanë, Bllatë, Morinë, Letaj (Qafë-Prush) Sopik, Pulajt. Rrjeti i gjerë i zyrave doganore, në kushtet kur qarkullimi i njerëzve dhe mallrave ishte i kufizuar, përbënte ngarkesë të panevojshme për financat e shtetit. Në ndonjë rast, si në Sopik, shpenzimet për mbajtjen e funksionimin e doganës, të cilat arrinin në 2040 fr. ar, ishin më shumë se sa të ardhurat e siguruar prej saj (1030 fr. ar).³⁵ Ato nuk ishin në gjendje të mirë dhe nuk siguronin kushtet minimale për punën e personelit.

Pengesë për mbarëvajtjen e punës së autoriteteve doganore, ishin marrëdhëniet midis tyre dhe rojeve të kufirit. Në mjaft raste, rojet e kufirit e policia e porteve, dilnin jashtë kompetencave të tyre dhe ndërhynin në veprimet e punonjësve të doganave. Për të rritur efektivitetin e doganave, ishte i domosdoshëm bashkëpunimi midis tyre por pa ndërhyrë në kompetencat e njëri-tjetrit. Sipas Ministrisë së Financave policia kishte si detyrë të informonte shefin e doganës për mallrat kontrabandë. Ajo duhej të ushtronte kontroll vetëm pasi të ishte kryer kontrolli doganor.³⁶

Një nga problemet me të cilat ndeshesh sistemi doganor dhe që ishte me pasoja tepër negative për nxjerrjen e të ardhurave, ishte fenomeni i kontrabandës. Ky fenomen në vitet 1925-1928, kushtëzohej nga një sërë faktorësh ekonomikë, shoqërorë dhe administrativë. Në kushtet e fuqisë së ulët blerëse si pasojë e varfërisë por dhe e çmimeve të larta, mallrat në treg lëviznin me vështirësi. Tregtarët, për të ruajtur normën e fitimit, gjenin si rrugë të mundshme, futjen e mallrave pa doganë. Ajo çka i krijonte hapësira veprimi kontrabandës, ishte korrupsioni i përhapur jo vetëm në nivele të ulëta të administratës por dhe në institucionet e larta shtetërore. Në informacionin e drejtorit të doganës në portin e Vlorës drejtuar MF, theksohej se vetë kontrabandistët në grindje midis tyre për mallrat që priteshin të vinin në port, kishin nxjerrë emrat e personave zyrtarë që i mbronin në veprimtarinë e tyre të kundërligjshme. “Kontrabanda, theksonte ai, nuk mund të ndalej kur ajo përkrahej nga nëpunësit më të lartë që kishin fuqinë në dorë.”³⁷ Në mjaft raste, doganierët për përfitime personale, bashkëpunonin me kontrabandistët të

³⁵ AQSH, F. 178, V. 1927, D. I-969, fl. 1-4. Raport i organizatorit të rojes së kufirit nënkolonel Domenico Silvester drejtuar MF, Tiranë, më 25 korrik 1928.

³⁶ Po aty, F. 152, V. 1927, D. 329, fl. 10. Telegram i MF drejtuar Kryesisë së Republikës, Tiranë, më 6 korrik 1927.

³⁷ Po aty, F. 152, V. 1926, D. 246, fl. 21. Informacion i drejtorit të doganës Vlorë, Rrok Brozi, drejtuar MF, Vlorë, më 14 janar 1926.

cilët kërkonin të shmangnin taksën doganore. Kështu, prefektura e Vlorës kishte denoncuar në MPB, dy punonjës të doganës në Palermo e Qeparo, të cilët kishin lejuar futjen pa doganë të 2500 okë vaj ulliri.³⁸ Prefektura e Korçës njoftonte komandën e jugut se nëpunësit e doganave merrnin ryshfete nga tregtarët dhe u vlerësonin mallrat e tyre me tarifa doganore shumë më të ulëta se sa ato të vendosura nga shteti.³⁹ Shpesh ata abuzonin me rregullat që përcaktonin veprimtarinë e doganave dhe silleshin me tregtarët në mënyrë arbitrare. Në informacionin që një tregtar italian i drejtonte zonëkomandantit, Ali Rizait, theksohej se në doganën e Vlorës nuk kishte rregull, nëpunësit e saj nuk tregonin as më të voglin respekt ndaj tregtarëve dhe përfaqësuesve të tyre. Shumë prej këtyre nëpunësve që deri dje kishin qenë roje, sot thonë “unë, more unë jam ligji”.⁴⁰ Qeverisë i erdhën ankesa edhe nga banorët e fshatit Palamba, në territorin e shtetit grek, të cilët për prodhimet bujqësore të tokave të tyre brenda kufijve të shtetit shqiptar, edhe pse ishin të përjashtuar nga taksa doganore, detyroheshin nga nëpunësit e doganave të paguanin deri 25 lireta.⁴¹ Tregtarët të përballur me qëndrimet jo ligjore të doganierëve, kishin frikë të ankoheshin, sepse ata mund t’u prishnin tregtinë. Në dokumente të kohës gjenden informacione për kontrabandë në pikat doganore në Qafë Prush (Zogaj), në ato të qarkut të Korçës, Shkodrës, Pogradecit, Himarës etj. Sipas këtyre të dhënave, dëshmohej se në qarkun e Shkodrës kontrabanda ishte shumë e zhvilluar. Aty futeshin mallra me “banderolla fallco” si duhani, cigaret, pije alkolike, vajra etj. Madje, kishte raste kur mallrat që bliheshin për industrinë e lehtë tjetërsoheshin dhe shiteshin për konsum ushqimor, të dëmshme për shendetin e popullit. Drejtori i doganës në Shkodër njoftonte se “kishte dyshim se vëllezrit Pogu, të gjithë vajrave dhe yndyrnave që merrnin për industrinë e sapunit, u kishin gjetur marifete dhe u hiqnin sodën kaustike, e i përzjenin me vajra e yndyrna të tjera dhe ia shisnin popullit e kontraktorëve.”⁴² Drejtoria e doganës së këtij qarku, i kërkoi qeverisë pajisjen e doganës

³⁸ *Po aty*, fl. 24. Telegram i prefekturës Vlorë drejtuar MPB, Vlorë, më 17 maj 1926.

³⁹ *Po aty*, F. 152, V. 1926, D. 200, fl. 14. Telegram i prefekturës Korçë drejtuar nënkomandantit të jugut, Korçë, më 6 tetor 1926.

⁴⁰ *Po aty*, F. 178, V. 1926, D. I-778, fl. 55-56. Letër e Zekino Matattio Lusino drejtuar zonëkomandantit Ali Riza, Vlorë, gusht 1926.

⁴¹ *AMPJ*, V. 1926, D. 166, fl. 163. Telegram i MPJ drejtuar MF, Tiranë, më 25 gusht 1926.

⁴² *AQSH*, F. 178, V. 1928, D. I-996, fl. 189. Telegram i drejtorit të doganave të Shkodrës, drejtuar MF, Shkodër, më 12 shkurt 1928.

me barka me motor për kontrollin e liqenit dhe rritjen e numrit të rojtarëve të fshehtë për zbulimin e kontrabandistëve.⁴³

Denoncime të herëpashershme i dërgoheshin qeverisë edhe për kontrabandën e alkoolit që zhvillohej nga anijet italiane në Shkodër. Ministri i Financave nga njëra anë, udhëzonte organet doganore të kapeshtin e të merreshin masa ndaj tyre, dhe nga ana tjetër, kërkonte që ato të mbaheshin sekret. Me këtë qëndrim, MF synonte ose të shmangte incidentet me shtetin fqinj ose të mbulonte lidhje të zyrtarëve të lartë me ta.⁴⁴

Në kushtet e mungesës së mjeteve të motorizuara për të kontrolluar zbulimin e kontrabandës në gjithë linjën bregdetare, u përdorën rojet e fshehta. Megjithë kontributin e përkushtimin e tyre dhe masat e tjera të marra nga qeveria në këtë drejtim, nuk qenë të mjaftueshme. Qarkkomanda e xhandarmërisë në Shkodër për ti prerë rrugën kontrabandës, kërkonte shtimin e rojeve të patrullimit sepse rojet e kufirit, theksonte ajo, janë larg njëra-tjetrës dhe “kontrabandistët hyjnë duke këndue.”⁴⁵ Ai sugjeronte të hartohej një ligj, ku të parashikoheshin masa të rrepta ndëshkuese ndaj kontrabandistëve.⁴⁶

Me pasoja negative për arkën e shtetit ishin mangësitë e vërejtura në dokumentacionin e kapitenerive të porteve detare. Kështu, në portin e Sarandës, që konsiderohej qendra më e rëndësishme tregtare, në një javë hynin 18 vaporë të shoqërive greke, italiane e jugosllave të cilat kishin 7 agjenci të tyre në atë qytet.⁴⁷ Aty nuk bëhej regjistrimi i rregullt i hyrjes e daljes së tyre. Edhe kur mbahej ndonjë e dhënë, bëhej me shumë gabime, sa që në librin e regjistrimit nuk mund të krijohej asnjë ide, madje dhe vetë punonjësit e doganës nuk mund të orientoheshin në regjistrat e tyre. Në kundërshtim me ligjin e nëpunësit, në doganën e Porto Palermos ishin punësuar persona të një familjeje, gjë që krijonte premisa për veprime abuzive.⁴⁸

⁴³ *Po aty*, fl. 200. Telegram i drejtorisë së doganave në Shkodër, drejtuar MF, Shkodër, më 4 janar 1928.

⁴⁴ *Po aty*, fl. 205.

⁴⁵ *Po aty*.

⁴⁶ *Po aty*, fl. 202. Telegram i MPB drejtuar MF, Tiranë, më 5 maj 1928.

⁴⁷ *Po aty*, F. 152, V. 1928, D. 4, fl. 14. Relacion i prefekturës Gjirokastër drejtuar MPB, Gjirokastër, më 26 shkurt 1928.

⁴⁸ *Po aty*, fl. 16. Telegram i prefekturës Gjirokastër drejtuar MPB, Gjirokastër, më 26 shkurt 1928.

Duke përfituar nga mungesat që kishin doganat por dhe forcat e kufirit e policia e porteve, anijet tregtare kryesisht italiane, për qëllim kontrabande, iu shmangeshin pikave doganore ku duhej të ndalonin e t'i nënshtroheshin kontrollit e taksave. Të njëjtin shqetësim ngrinte edhe drejtori i portit të Sarandës për mjetet greke të lundrimit. Ai vinte në dijeni MF, se anije e barka greke deri 3 tonëshe vinin nga Korfuzi dhe hynin lirisht në brigjet shqiptare. Ato transportonin duhan, vajguri e mallra të tjerë që ishin monopol shteti edhe në Greqi.⁴⁹ Në këtë mënyrë ato shkelnin rregullat e ligjet ndërkombëtare, pasi ato nuk ishin të manifikuara me dokumente të rregullta nga shteti grek.⁵⁰ Kontrabanda zhvillohej edhe për ato mallra që ishin monopol i shtetit shqiptar. Madje, ajo e pijeve alkolike, e kripës dhe e duhanit ishte shumë fitimprurëse për kontrabandistët ku përfshiheshin edhe zyrtarë të lartë. Sipas informacioneve, hapësira ku zhvillohej kontrabandë e madhe ishte ajo midis lumit Shkumbin e skelës së kripës në Kavajë.⁵¹

Përmirësimi i veprimtarisë në dogana, para së gjithash kërkonte forcimin e ruajtjes së kufirit tokësor dhe sidomos atij detar. Për këtë Zogu, urdhëroi MF për blerjen e anijeve nga Italia dhe vënien e tyre në shërbim të rojës kufitare.⁵² Po kështu ai u kërkoi autoriteteve italiane të dërgonin pranë qeverisë shqiptare një specialist për organizimin e doganave. Qeveria italiane dërgoi në Shqipëri nënkolonelin Domenico Silvester. Organizimin doganor ai e pa të lidhur ngushtë me organizimin e rojës së kufirit në të gjithë territorin. Në këtë drejtim, ai dha një kontribut të veçantë, në mënyrë që veprimi i doganave t'i përshtatej plotësisht detyrave të saj.⁵³ Sipas tij organizimi i rojës së kufirit, do të sillte çlirimin e personelit të doganave nga çdo detyrë roje jashtë zyrave dhe do të bënte që ai t'i përkushtohej funksionimit të punës themelore të tij, në vërtetimin dhe nxjerrjen e të ardhurave.⁵⁴ Dogana dhe roja e kufirit

⁴⁹ AMPJ, V. 1925, D. 26, fl. 22. Telegram i nëndrejtorit të doganës Sarandë drejtuar MPB, Sarandë, më 23 maj 1925; AQSH, F. 152, V. 1926, D. 246, fl. 26. Telegram i MPB drejtuar Komandës së Përgjithshme të Xhandarmërisë, Tiranë, 15 shkurt 1926

⁵⁰ Po aty.

⁵¹ AQSH, F. 178, V. 1928, D. I-996, fl. 27. Telegram i zyrës doganore Seman drejtuar MF, Seman, 25 prill 1928.

⁵² AMPJ, V. 1925, D. 26, fl. 8. Telegram i kryesisë së Republikës drejtuar MF, Tiranë, më 17 dhjetor 1925.

⁵³ AQSH, F. 178, V. 1927, D. I-969, fl. 1-4. Propozime të organizatorit D. Silvester për organizimin doganor drejtuar MF, Tiranë, më 25 korrik 1928.

⁵⁴ Po aty.

ishin dy gjymtyrë kryesorë në rregullimin doganor. Ata duhej të vepronin në harmoni e në respekt të plotë të ligjit. Roja i kufirit nuk duhej të ndërhynte në punën e organit që kishte të drejtën e nxjerrjes së taksave. Ata duhej të vëzhgonin reciprokisht në bazë të rregullave e të tregonin respektin e duhur ndaj nëpunësve të veshur me detyra publike.⁵⁵ Veprimtaria e tyre duhej të bazohej në ligje e rregullore për t'iu përgjigjur nevojave aktuale të shtetit shqiptar. Silvester, mbështetur në përvojën e tij sugjeroi që legjislacioni i ri për doganat të përcaktonte vijën doganore në kufirin tokësor, klasifikimin e doganave sipas rëndësisë së tyre, detyrimet e kapitenëve të vaporëve e anijeve, të drejtat e ushtrimit të organeve të rojes, disiplinimin e veprimeve të ndryshme doganore, detyrimin e cilitdo për të deklaruar prejardhjen e mallrave që lëviznin në tokën e shtetit etj.⁵⁶

⁵⁵ *Po aty.*

⁵⁶ *Po aty.* Çështjet e propozuara nga organizatori Silvester për hartimin e legjislacionit të ri doganor ishin si vijon: 1. Caktimi i vizës doganore në kufirin tokësor, mallrat për tregti do t'u nënshtroheshin kontrollit dhe zbatimit të formaliteteve për detyrimet fiskale; 2. Klasifikimi i doganave dhe kufizimi i kompetencave në krahasim me rëndësinë e tyre; 3. Fiksimi i rrugëve dhe pikat ku mund të përshkohet si në hyrje dhe dalje për tokë dhe ajër; 4. Rregullimi i mjeteve që mbërrijnë dhe dalin nga deti, toka dhe ajri; 5. Caktimi i distancës së ujrave detarë, detyrimet e kapitenëve te vaporëve dhe anijeve e të drejtat e ushtrimit të organeve të rojes; 6. Përshkrimet mbi kontrollimin e vaporëve e anijeve që mbërrinin e dilnin në skelat e shtetit duke procedue një herë mbi ushqimin e personelit të anijeve dhe udhtarëve; 7. Disiplinimi i operacioneve të ndryshme doganore, pagesat e nxjerrjet e të drejtave e veçanërisht kontabilizimi i tyre; 8. Rregullimi me kujdes të posaçëm i dërgesave të tregtisë së jashtme nga njëra doganë në tjetrën e në tranzite, e ato tregtare e të nacionalizuara që përshkohen me anë të detit dhe veçanërisht caktimin e instituteve që do të kenë në kompetencë kthimin e të drejtave të marruna me depozitë e me dorzani; 9. Përshkrimin e depove të ndryshme, rregullimin e funksionimi i tyre; 10. Mbizotërimin e doganave që do të mundën të pranojnë në magazinat e tyre tregëtira që vijnë nën regjimin e tranzitit, ato të cilat do të kenë për detyrë të vërtetojnë daljen jashtë kufirit me anë të tokës që do t'iu lejohet të kthejnë të drejtat; 11. Rregullimin e godinave të ngritura anës së detit; 12. Disponimi që çdo dëftesë pagese të sjellë shënime autentike të gjërave që i përket e se asnjë nga këto nuk do të jetë e vlefshme pa pasur visitimin (për dalje) të rojes së kufirit; 13. Caktimin e detyrave dhe kompetencave të gardës kufizore, mbi shërbimet e rojes e përballimin e vendeve të kalimit doganor; 14. Pohimin e parimit që kush do që transporton ose që ka në gjithë tokën e shtetit tregëtira të jashtme e që u ushtrohen të drejtave të kufirit, të jetë i detyruar të tregojë e justifikojë ligjërisht prejardhjen e tyre; 15. Përfundimin juridik të fajeve, kontrabandë, pjesëtimi i rasteve të kontrabandave formale dhe të kontravencioneve; 16. Determinimin e kompetencave që do të ketë roja kufitare e cila si organ i policisë gjyqësore do të mund të bëjë kërkime e shtrëngime për ndalimin e fajeve fiskale; 17. Rregullimin me

Me rëndësi ishte propozimi i tij për të rregulluar me ligj të posaçëm, mbajtjen e statistikave për lëvizjen e mallrave, të cilat do t'i shërbenin policisë fiskale për të pasur një pasqyrë të qartë të lëvizjes së tregtisë, e cila do të relatohej në çdo tre muaj. Për mbajtjen e statistikave duhej të caktohej një taksë fiskale.⁵⁷ Nga vëzhgimet e studimet e bëra për gjatë gjithë vijës së kufirit, ai e shihte të nevojshme reduktimin e dy pikave doganore Sopik dhe Pulaj.⁵⁸

Ministria e Financave, mbështetur në sugjerimet e tij si dhe në informacionet që i vinin mbi veprimtarinë e doganave, mori masa për përmirësimin e gjendjes në sistemin doganor. Kështu, zyra e doganës së Urakës u zhvendos në Presponi (në livadhet e Qafë-Thanës) ku u ngrit një ndërtesë e re që shërbente si zyrë doganore dhe si vend për fjetjen e një toge të ushtrisë.⁵⁹ Kjo zhvendosje do të ndikonte në lehtësimin e aktivitetit të tregtarëve që vinin nga Korça për në Elbasan si dhe do të pengonte hyrjen e daljen e të arratisurve politikë nga drejtimi i Qafë Thanës.

MF në zbatim të ligjit mbi taksimin e duhani, mori një sërë masash për të vënë nën kontroll prodhimin dhe tregtimin e duhanit e cigareve.⁶⁰ Të gjithë personat që transportonin duhan e cigare, detyroheshin të merrnin leje kalimi nga zyrat e financës. Për të marrë lejen, tregtari duhej të deklaronte sasinë e mallit, emrin e tij dhe të personit që ia kishte blerë. Çdo prodhim i duhanit që transportohej pa lejen përkatëse, konsiderohej kontrabandë.⁶¹ Masat që mori MF do të ndikonin në shmangien e veprimtarisë prodhuese e tregtare informale, ulnin invazionin fiskal dhe

ligj të posaçëm i një takse statistike mbi sendet që do të importohen e eksportohen, mbi kokë, mbi peshë, copë e në një masë që shkëlqesia juaj ka për ta gjetë të arsyeshme. Me një të ardhur të tillë, shteti do të përfitojë të gjitha shpenzimet që sot bën për shërbimin e statistikës, shërbim i cili do të përmirësohet në mënyrë që të paktën për qëllime të brendshme dhe të policisë fiskale, do të njoftojë rezultatet e lëvizjes së lirë të tregtisë rregullisht e në çdo tremujor.

⁵⁷ *Po aty.*

⁵⁸ *Po aty.*

⁵⁹ *AQSH*, F. 152, V. 1927, D. 1000, fl. 95. Telegram i nënprefekturës Pogradec drejtuar MPB, Pogradec, më 20 gusht 1927.

⁶⁰ *Fletorja Zyrtare*, nr. 216, Tiranë: 8 dhjetor 1926. Dekretligjë mbi administrimin e taksimit të duhanit.

⁶¹ *Fletorja Zyrtare*, nr. 142, Tiranë: 25 gusht 1926. Projekt-rregullore mbi zbatimin e ligjës mbi taksimin e duhanit.

ndikonin në ndërgjegjësimin e shtetasve për domosdoshmërinë e zbatimit të rregullave dhe ligjit në tërë veprimtarinë e tyre.

Përgjegjësinë e drejtpërdrejtë në veprimtarinë e doganave e kishin punonjësit e tyre. Prandaj, herë pas here MF u tërhoqte vëmendjen për zbatimin e rregullave e ligjeve në fuqi. Në të njëjtën kohë merrte masa administrative e ndëshkimore ndaj atyre nëpunësve të doganave që abuzonin në detyrë. Kështu u pushua nga puna doganieri i Pogradecit, Cuf Lohja,⁶² vërtetuesi i doganës së Durrësit Faslli Frashëri, i cili iu dha për ndjekje organeve gjyqësore,⁶³ u pushua nga puna doganieri i Kapshticës etj.⁶⁴ Zëvendësministri i Drejtësisë, Ferit Vokopola, i kërkoi prokurorisë dhe gjykatave që ndaj personave të akuzuar për kontrabandë, të zbatoheshin nën 10 i ligjit për ndalimin e kontrabandës, i janarit 1927.⁶⁵ Ndërsa MF udhëzonte zyrën doganore të Durrësit që nëpunësit e doganës të cilët kapeshin duke ndihmuar kontrabandistët, duhej të dërgoheshin në gjyq dhe të gjykoheshin sipas nenit 2 e 3 të ligjit për gjykimin e nëpunësve. Gjithashtu, ajo e shihte të panevojshme dhënien e mendimit nga zyrat doganore për nëpunësit që abuzonin me detyrën dhe merreshin në proces gjyqësor, sepse kështu mund të ndikonin në pavarësinë e gjykatave.⁶⁶

Masat e marra nga autoritetet shtetërore, filluan të jepnin efektin pozitiv në punën e doganierëve. Ata, shpesh kërkonin zbatimin e rregullave nga të gjithë personat që kalonin në doganë, përfshirë dhe zyrtarët e lartë, të cilët, duke shfrytëzuar postin e tyre, në ndonjë rast kundërshtonin kontrollin doganor. Kështu, nëpunësi i doganës së Durrësit Abdi Gole, nuk iu nënshtroa presionit të major Preng Previzit që bagazhet e tij dhe të oficerëve italianë që shoqëronte, të mos u nënshtroheshin kontrollit me pretekstin se ishin zyrtarë të lartë. Doganieri e konsideronte veten të pavarur nga asnjë autoritet në kryerjen e detyrës

⁶² *AQSH*, F. 152, V. 1926, D. 246, fl. 70. Telegram i nënprefektit të Pogradecit drejtuar MPB, Pogradec, më 29 maj 1926.

⁶³ *Po aty*, F. 178, V. 1928, D. I-996, fl. 121. Telegram i A. Zogut drejtuar MF, Tiranë, më 28 gusht 1928.

⁶⁴ *Po aty*, fl. 141.

⁶⁵ *Po aty*, fl. 24. Qarkore e Ministrisë së Drejtësisë, drejtuar Prokurorisë, Tiranë, më 14 shkurt 1928.

⁶⁶ *Po aty*, fl. 107. Telegram i MF drejtuar zyrës doganore Durrës, Tiranë, më 11 korrik 1928.

dhe i detyroi ata t'i nënshtroheshin kontrollit.⁶⁷ Po kështu edhe George Prifti, pas vizitës në Shqipëri në vitin 1928, shkruante në gazetën "Dielli", "... se nëpunësit e doganës së Durrësit i kishin lënë përshtypje të mirë, pasi ata zbatonin ligjin pa dallim për të gjithë qytetarët njësoj."⁶⁸

Një burim i mirë për arkën e shtetit në ato vite, ishin të ardhurat nga monopoli i shtetit mbi kripën, letrat e cigareve, shkrepëset, letrat e lojës, të cilat arritën nga 1.466.610 fr. ar në vitin 1925-1926, në 1.500.506 fr. ar në vitin 1927-1928.⁶⁹ Edhe tatimi mbi konsumin për disa mallra me përdorim të gjerë si kafeja, sheqeri, vajguri, benzina, birra etj., patën ndikim të dyfishtë, nga njëra anë rritën të ardhurat në buxhetin e shtetit por nga ana tjetër vështirësuan gjendjen ekonomike të shqiptarëve.

Pavarësisht nga mungesat e dobësitë në veprimtarinë e doganave, në vitet 1925-1928 të ardhurat prej tyre mesatarisht arritën në 1,3 deri në 2.8 milion fr. ar. në vit.⁷⁰ Ky rezultat ishte pasojë sa e masave që mori qeveria për përmirësimin e veprimtarisë së doganave, aq dhe i rritjes së tarifave doganore, megjithëse efekti negativ i saj në zhvillimin e tregtisë dhe uljen e fuqisë blerëse, nuk mund të shmangej.

⁶⁷ AQSH, F. 178, V. 1928, D. I-996, fl. 63. Telegram i komandës së baonit të Erzenit drejtuar komandës së grupimit të I, Tiranë, më 25 qershor 1928. Dy nëpunës të doganës së Durrësit u ankuan për veprimin e majorit P. Previzi, në komandën ku ai shërbente. Në sqarimin e tij për komandën e grupit I, P. Previzi theksonte: "Me misionin e oficerëve të përbamë prej organizatorit të gardës major Di Pievo, kapitenëve Shaban Bega, Faik Quku, toger Sytki Shkupi, dualmë në skelë me valixhet tona që kishim me rroba vetiake. Insistova që të mos kontrolloheshin, por një doganier Abdi Gole, insistonte që t'i kontrollonte ato. Kështu A. Gole tha që "valixhet do të qëndrojnë këtu dhe se e dimë ne vet detyrën se kur i kontrollojmë. Iu luta, theksonte Previzi, si më i vjetri dhe për nder të detyrës si ushtarak dhe të oficerit italian, por ky (doganieri) jo vetëm që nuk e mori parasysh lutjen time por m'u përgjigj tuj thanë se: "na nuk i njofim këto misione dhe sa e sa oficera dhe kësi teshash vijjnë e dalin këtu", dhe shtoj "se qeveria shqiptare nuk është si ajo qeveri ku keni qenë juve [italiane], po jemi nëpunës me ndërgjegje e jo vetëm që nuk bëjmë abuzime por dhe miqësinat nuk i shikojmë". Atëherë desha të fjalosësja me ministrin e Financave por telefoni nuk punonte. Ai nëpunësi A. Gole me tha, "se ç'këtu jam vetë ministër! Se sa ministra hypin e zdrypin në Tiranë nuk mund të influencojnë në detyrën teme, e më duket se u paska turbullue shumë vapori z. major".

⁶⁸ Gazeta *Dielli*, nr. 4042(735), Boston Mass., 31 janar 1928.

⁶⁹ B. Meta, *Politika tatimore në Shqipëri ...*, f. 45.

⁷⁰ *Po aty*, f. 39.

S u m m a r y

THE MEASURES FOR THE RE-ORGANIZATION OF THE TAX AND REVENUE
SYSTEMS IN THE REPUBLIC OF ALBANIA
(1925-1928)

This article is a continuation of a previous paper published in the “Historical Studies” journal, no. 1-4, 2018, entitled “The financial administration reform in Albania between 1925 and 1928”. It focuses on the measures taken by the Albanian government for the reorganization of the revenue and customs duties system in Albania.

The tax system inherited from the Ottoman period continued to be in use in Albania, with minor changes, even after the establishment of the Albanian independent state. Moreover, the collection and administration of tax revenues was a poorly organized and problematic process. In order to improve the situation of the direct tax revenues system the government undertook several reforms which aimed at restructuring the old system in use. To this end attempts were made to replace the tithe with a land property tax while the cattle tax (*xhelep*) was modified. This article deals with the difficulties and obstacles encountered in implementing these reforms, such as the lack of financial resources to collect new taxes, issues with the land registration data, the reaction of the tithe collectors and state officials related to them, etc. The objective and subjective problems faced in reforming the direct tax revenue system made the government intervene for the first time in reorganizing the indirect tax system according to the experience of more developed European countries, adding a variety of such taxes and raising the existing ones. This brought an increase in the total income of the state budget from 10.3 million gold francs in 1925-1926 to 15 million gold francs in 1928-1929.

This article deals also with the reforms in the customs duties system which aimed at improving its structure and operation by establishing new custom houses and increasing the cooperation between the border patrol police and the customs officials, assigning clear cut responsibilities and rights to each party. A particular attention is given to the measures taken in fighting smuggling through the customs. Based on documentary evidence there have been cases of administrative and penal punishments for several customs’ officials.